



**ODA E INXHINIERËVE  
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

# Trajnimi i parë 2026

Drejtimi Elektroteknikë

Tema: “Menaxhimi dhe Mirëmbajtja e Sistemeve Elektroenergjetike”

30 Maj 2026



## Qëllimi i Trajnimit

1. Të kuptohet mbi **Menaxhimin e Sistemeve Elektroenergjetike (SEE)**
2. Të njoftohen me **Strategjinë e Mirembajtjes**, duke përfshirë **Mirëmbajtjen Preventive, Planifikimin e Mirëmbajtjes** së Paisjeve (Transformatorëve, Linjave, Ndërprerësave të TM dhe TU) si dhe **Monitorimin** e gjendjes së Paisjeve.
3. Të njoftohen me **Ndërperjet dhe Prishjet në Rrjet**, duke Identifikuar shkaqet, siç janë: **Mbingarkesat, Prishjet teknike** si dhe **Faktorët e jashtëm**.

# Agjenda

- Sistemet Elektronergjetike (SEE) – në përgjithësi**
- Menaxhimi i SEE në kushte normale**
  - ❖ Operimi i Strukturave të SEE
- Strategjia e Mirembajtjes**
  - ❖ Mirëmbajtja Preventive EPM,
  - ❖ Planifikimi i Mirëmbajtjes së Pajisjeve
    - Transformatorëve,
    - Linjave,
    - Stabilimenteve të TM dhe Ndërprerësve TM
    - Stabilimenteve të TU dhe Ndërprerësve TU
    - Monitorimi i gjendjes së Pajisjeve
- Rastet praktike**
- Diskutimi interaktiv**

# Menaxhimi i SEE në Kushte normale Operimi te Strukturave të SEE

- **Sistemet Elektroenergjetike (SEE) shërbejnë për Furnizim me Energji Elektrike të Konsumatorëve Industrial, Komercial dhe në Amvisëri.**

**Menaxhimi dhe Mirëmbajtja Efikase e SEE janë thelbësore për:**

- **Siguri në Furnizim me Energji Elektrike;**
- **Vazhdimësi të Furnizimit dhe Kualitetativ me Energji Elektrike;**
- **Reduktim të Humbjeve Teknike dhe Komerciale;**
- **Rritje të Jetëgjatësisë së Paisjeve Elektrike;**
- **Ulje të Kostove Operative dhe të Mirëmbajtjes.**

**Sistemi Elektroenergjetik (SEE) përfshin:**

- **Prodhimin e Energjisë Elektrike;**
- **Transmetimin;**
- **Shpërndarjen;**
- **Furnizimin, dhe**
- **Konsumin e Energjisë Elektrike.**

## Menaxhimi i SEE në Kushte normale Operimi te Strukturave të SEE

- **Sektori i Energjisë** deri vonë, ka qenë i integruar **vertikalisht**, me të gjitha funksionet e **Gjenerimit, Transmetimit dhe Shpërndarjes së Energjisë**.
- **Sektori i Rregulluar i Energjisë** funksionon brenda **Ligjeve** dhe **Rregulloreve** të specifikuara nga **Qeveria**, pra funksionon në një **Mjedis Monopolistik dhe pa Rreziqe**.
- Në modelin e **Derregulluar**, rrjedha e energjisë është nga **Elektranat tek Konsumatorët**, përmes **Sistemit të Shpërndarjes**, e në disa raste edhe përmes **Sistemit Transmetues**.
- **Sektori i De-rregulluar i Energjisë** karakterizohet nga një **Strukturë Konkurruese** dhe se procedura e ristrukturimit quhet **Shthurje**.

## Menaxhimi i SEE në Kushte normale Operimi te Strukturave të SEE

- **Kompanitë e Furnizimit** të Energjisë konsiderohen si hyrje të reja në Sektorin e Energjisë, detyra e të cilave është **të shesin dhe të blejnë energji nga Prodhuesit** dhe pastaj të ia **shesin atë drejtpërdrejt Konsumatorëve.**

**Pas Ristrukturimit të Sektorit Energjetik në Kosovë kemi një situatë të re, si:**

- **Gjenerimi** është në pronësi të Shoqërive Aksionare dhe Kompanive private,
- **Transmisioni** ka mbetur publik dhe ka Monopol.
- **Shperndarja** eshte privatizuar.
- **Konsumatorët Industrial dhe Komericial si dhe ata të vegjël** blejnë Energji Elektrike nga **Kompanitë Furnizuese.**


## Menaxhimi i SEE në Kushte normale Operimi te Strukturave të SEE

- Ristrukturimi i SEE ka një ndikim të madh në **Funksionimin dhe Planifikimin e SEE.**
- Rrjetat e **Transmisionit dhe Shpërndarjes** për shkak të vjetërisë **bëhen të pasigurta** nga **Pasiguritë operacionale** dhe **Sfidat e paparashikuara.**

Rrjeti i Mençur (*Smart Grid*) është **Përgjigjja** e **Pasigurive** dhe **Sfidave**, që:

- Mundëson pjesëmarrje aktive te **Konsumatorëve** në konsum;
- Siguron **Energji kualitative** që plotëson nevojat e shekullit XXI;
- Akomodon të gjitha teknologjitë e **Gjenerimit dhe Ruajtjes së energjisë;**
- Mundëson **Produkte, Shërbime dhe Tregje të reja;** dhe
- Optimizon përdorimin e **Aseteve dhe Efikasitetin e Operimit.**

# Menaxhimi i SEE në Kushte normale Operimi te Strukturave të SEE



## Menaxhimi i SEE në Kushte normale Operimi te Strukturave të SEE

Menaxhimi i Sistemit Elektroenergjetik (SEE) paraqet procesin e **Planifikimit**, **Organizimit**, **Monitorimit** dhe **Kontrollit** të të gjitha Komponentëve të SEE, me qëllim të **sigurimit të funksionimit të besueshëm dhe ekonomik**.

Objektivat kryesore janë:

1. **Siguria e Stabilitetit të SEE;**
2. **Menaxhimi Optimal i Ngarkesës;**
3. **Minimizimi i Ndërprerjeve;**
4. **Rritja e Efikasitetit Energjetik;**
5. **Integrimi i Burimeve të Ripërtëritshme (BRE);**
6. **Digjitalizimi dhe Automatizimi i Rrjetit.**

# Menaxhimi i SEE në Kushte normale Operimi te Strukturave të SEE

- **Mirëmbajtja** është grupi i Aktiviteteve teknike dhe organizative që realizohen për të mbajtur Pajisjet në gjendje Optimale Funksionimi.
- Nëse përkeqësimi i Paisjeve elektrike apo Degradimi nuk kontrollohet, mund të shkaktoj Prishje apo rënie të pa planifikuara nga Operimi, të Paisjeve elektrike, e poashtu edhe keq Funksionim.

**Qëllimet e Mirëmbajtjes janë:**

- Parandalimi i Prishjeve;
- Zvogëlimi i Ndërprerjeve;
- Rritja e Besueshmërisë;
- Siguria e Personelit dhe Pajisjeve;
- Zgjatja e Jetës operative të Pajisjeve.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

- **Funksionimi i rregullt i një Pajisje elektrike** realizohet me **Mirëmbajtje Preventive të Pajisjeve (*Equipment Preventive and Maintenance - EPM*)**, **Program të Testimit** si dhe gjetjen e **Mënyrave për Korigjimin e Prishjeve**.
- **EPM** kryhet në intervale të planifikuara kohore.
- Me një **EPM** dhe **Program të Testimit**, mund të **zbulohen** dhe **korigjohen** Rreziqet e mundshme që mund të shkaktojnë **Prishjen** e Paisjeve ose ndërprerjen me Furnizim me Energji Elektrike si dhe do të minimizoj Rreziqet për jetëgjatësinë e Paisjeve, nëse ato nuk mirëmbahen siç duhet.
- **Programi i Mirembajtjes dhe Testimit** mund të zbatohet duke krijuar një **Departament Mirëmbajtjeje** ose duke **kontraktuar një Kompani** që merret me këtë.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

- Programi **EPM** duhet të përbëhet nga **Inspektime Rutinore, Testime, Riparime dhe Servisime të Komponentëve të Rrjetit Elektrik**, siç janë Transformatorët, Kabllot, Linjat Ajrore, Stabilimentet Shpërndarëse dhe Ndërperësit, Pajisjet e Monitorimit dhe Matjes si dhe Pajisjet që Zbulojnë Prishjet.
- Programi **EPM** është një Program i organizuar dhe i zbatuar mire, që minimizon numrin e aksidenteve dhe ndërprerjeve të paplanifikuara, dhe rrit Kohën Mesatare Midis Prishjeve (**MTBF**) të Paisjeve Elektrike.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

Përfitimet e **EPM** mund të kategorizohen si:

- ***Perfitimet Direkte***

- Ulja e kostos së Operimeve dhe Riparimeve
- Planifikimi me i mire i Punimeve dhe Zvoglimi i kohës së Rënies nga Puna e Paisjeve, dhe
- Rritja e Sigurisë së Personelit dhe Aseteve.

- ***Perfitimet Indirekte***

- Përmirësimi i Moralit të Punonjësve,
- Ekspertizë më e madhe në Punë,
- Rritja e Produktivitetit, dhe
- Zbulimi i Prishjeve që janë të natyrshme në Sistem ose që kanë lindur përmes ndryshimeve të mëvonshme.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

**Pjesa më e madhe e Aktiviteteve të Mirëmbajtjes Preventive të Pajisjeve elektrike mund të përmblihen me katër rregulla:**

- **Mbajtja e Paisjeve të Thata**
  - **Mbajtja në Vende të Pastërta**
  - **Mbajtja në Vende të Ftohta, dhe**
  - **Mbajtja e Paisjeve të Përforuara (Fiksuara) mirë.**
- Shumica e Paisjeve elektrike i nënshtrohen një numri relativisht të vogël **Mekanizmash degradimi**, dhe **qëllimi i shumicës së Aktiviteteve të EPM** është: **Parandalimi**, **Ngadalësimi** ose **Zvogëlimi i ndikimit të tyre**.
- Vendimi se cila qasje do të përdoret varet kryesisht nga Specifikat e Sistemit dhe Paisjeve, si dhe nga Filozofia e Menaxhimit.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

Ekzistojnë një numër i **Qasjeve tradicionale** ndaj **Mirëmbajtjes** së Paisjeve elektrike, siç është:

### □ “*Puna deri në Dështim/Prishje*” (“*Run-To-Failure*” - RTF)

- Në këtë qasje, **EPM** nuk kryhet fare.
- Pajisjet e konsumuara **Riparohen** ose **Zëvendësohen** vetëm kur pasojat e konsumimit bëhen të papranueshme (për shumicën e pajisjeve elektrike kjo korrespondon me **Prishje katastrofike**).
- Nuk ka asnjë përpjekje për të **Monitoruar Performancën** ose për të **Parandaluar Prishjen** dhe rreziqet që lidhen me Prishjen pranohen.
- Qasja “*Puna deri në Dështim*” në përgjithësi ofron **Besueshmëri** dhe **Disponueshmëri** të kënaqshme në **Aplikimet jo-kritike**.
- Kompanitë e vogla **që nuk kanë Personel të Mirëmbajtjes**, shpesh e përdorin këtë Qasje.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

- ❑ **“Inspektim dhe Shërbim Vetëm kur është e nevojshme”**
  - Kjo Qasje është një **përmirësim** në krahasim me Qasjen **“Puna deri në Dështim”**, ku **Personeli i Mirëmbajtjes Inspektojnë pajisjet Elektrike në një Orar pak a shumë të rregullt (shpesh gjatë “Vizitave rutinore“)**.
  - Në këtë Qasje, **Prishjet fillestare** në përgjithësi **korrigjohen para se të bëhen katastrofike** dhe zakonisht ka **Monitorim joformal të Performancës** për të parashikuar Prishjet e ardhshme.
  - Shumë Kompani e përdorin këtë Qasje.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

*Inspektim dhe Shërbim Vetëm kur është e nevojshme*

Para



Pas



Zevendesimi i Transformatorit të Mbingarkuar, Mirembajtja Preventive qe e mbron Transformatorin nga Djegia

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

### □ “*Mirëmbajtja Preventive e Planifikuar*”

- Në këtë Qasje, Aktivitetet e “*Mirëmbajtjes Preventive të Planifikuar*” kryhen në **Intervale të caktuara kalendarike, Orë pune** ose **Cikle pune**.
- Si **Procedurat** ashtu edhe **Orari** bazohen më shpesh në Rekomandimet e Prodhuesit ose Standardet e Industrisë.
- Arsyeja që Qasja e “*Mirëmbajtjes Preventive të Planifikuar*” e siguron **Inspektime periodike të Paisjeve**, e bënë që kjo Qasje është aktualisht Qasja mbizotëruese në Kompanitë ku **Produktiviteti** dhe **Siguria** kanë përparësi.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

### □ “*Mirëmbajtja e Përqëndruar në Besueshmëri*” (*Reliability Centered Maintenance - RCM*),

- RCM përfshin **Specifikimin dhe Planifikimin e Aktiviteteve EPM**, bazuar në **shkallën statistikore të Prishjeve dhe Jetëgjatësinë e pritur të Pajisjeve** që Mirëmbahen dhe **Kritikalitetin dhe Produktivitetin** e tyre.
- RCM gjithashtu përfshin **Përditësimin** e vazhdueshëm të **Procedurave dhe Orareve të EPM**.
- RCM është Qasja më efektive nga ana e **Kostos** sepse rrit: **Sigurinë e Kompanisë, Besueshmërinë dhe Disponueshmërinë**, ndërsa njëkohësisht **zvogëlon Kostot e Mirëmbajtjes**, duke u përqendruar në Mirëmbajtje të Pajisjeve që janë më kritike dhe/ose problematike, dhe duke zvogëluar dhe eliminuar Mirëmbajtjen e panevojshme në Paisjet që janë më pak kritike dhe/ose relativisht të Besueshme.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

- Programi gjithëpërfshirës RCM përfshin gjithashtu **Procedura të strukturuar** për hetimin e shkakut rrënjësor të Prishjes dhe **Korrigjimin e Problemeve**, si dhe për **Monitorimin e Performancës** për të parashikuar Prishjet e ardhshme.
- RCM përdoret gjerësisht në **Ushtri** dhe po përdoret gjithnjë e më shumë në **Termocentralet bërthamore** dhe **Kompanitë Prodhuese**, dhe përfitimet e tij njihen gjithnjë e më shumë.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

### □ *Faktorët për Optimizim të Mirëmbajtjes Preventive të Pajisjeve*

- ❖ Ndikimi i Prishjeve të Paisjeve në Siguri
- ❖ Ndikimi i Prishjeve të Paisjeve në Produktivitet dhe Rentabilitet (duke përfshirë Kostot e mosprodhimit, si dhe Kostot e Riparimit ose Zëvendësimit të Pajisjeve të Prishura)
- ❖ Kostot e Mirëmbajtjes Preventive (EPM)
- ❖ Frekuenca e Prishjeve dhe Jetëgjatësia e Paisjeve
- ❖ Aftësia për të parashikuar Prishjen
- ❖ Mundësia e shkaktimit të Prishjes të Paisjeve ose Problemeve të Sistemit gjatë Mirëmbajtjes dhe Testimit
- ❖ Ekspertiza Teknike e Personelit të Mirëmbajtjes
- ❖ Disponueshmëria e Informacionit të Besueshmërisë së Pajisjeve

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

### □ *Kriteret e Përgjithshme për një Program Efektiv të Mirëmbajtjes Preventive dhe Testimit për Pajisjet Elektrike*

- ❖ **EPM** duhet të kryhet nën Kontrollin e përcaktuar nga Menaxhmenti
- ❖ **EPM** duhet të kryhet në përputhje me Praktikën dhe Oraret e përcaktuara
- ❖ **EPM** duhet të kryhet nën një udhëheqje të caktuar qartë, duke paraparë sakt Burimet e mjaftueshme (Personelin, Objektet, Mjetet, Pajisjet e Testimit, Trajnimet, Inxhinierët dhe Administratën).
- ❖ **Aktivitetet e EPM** duhet të prioritizohen sipas rëndësisë së Sistemeve dhe Pajisjeve, në mënyrë që sa më shumë Burime t'u ndahen Pajisjeve, Nën sistemeve dhe Sistemeve që janë të rëndësishme për Sigurinë.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

- ❖ **EPM** duhet të kryhet sipas **Procedurave të shkruara të qarta**, bazuar në **Karakteristikat Specifike të Pajisjeve, Përdorimin e tyre dhe Mjedisin.**
- ❖ **Procedurat dhe Oraret e EPM** duhet të **Monitorohen** dhe të **Rishqyrtohen**, për të siguruar që **ndryshimet procedurale dhe Modifikimet** të përfshihen në objekt.
- ❖ Duhet të përditësohen të dhënat e **Mirëmbajtjes, Testimit dhe Operimit** të Objektivit.
- ❖ **Personeli** që duhet të kryej **EPM**, duhet të jetë i **trajnuar.**
- ❖ **Menaxhmenti** duhet të **Monitoroj** dhe **Vlerësoj** vazhdimisht **Efektivitetin e Programit EPM** dhe të bëjë ndryshimet e nevojshme në përgjigje të problemeve të identifikuara dhe përparimeve në teknologjinë e Mirëmbajtjes.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

- ❑ ***Kualifikimet e Personelit që kryejnë Mirëmbajtje Preventive***
  - ❖ **Jo-specialistët (Operatorët)** mund të kryejnë **Inspektime Sipërfaqësore**
  - ❖ **Mirëmbajtja Preventive në Paisjet dhe Sistemet Kritike** duhet të kryhet të paktën nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë dhe aktive të, **Teknikëve të Mirëmbajtjes**, të Trajnuar dhe me Përvojë.
    - Operacione të tilla zakonisht përfshijnë: **Inspektimin e brendshëm, Testimin, Kalibrimin dhe Rivitalizimin.**

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

**Trajnimi për Mirëmbajtjen Preventive Elektrike në Pajisjet dhe Sistemet Kritike përfshin:**

- **Bazat e inxhinierisë elektrike**
- **Teknikat e përgjithshme të Mirëmbajtjes Elektrike**
- **Metodat dhe Praktikat e Sigurisë Elektrike**
- **Projektim dhe Funkcionim të Paisjeve dhe Sistemeve që Mirëmbahen**
- **Procedurat e Mirëmbajtjes dhe Testimit të Paisjeve dhe Sistemeve që Mirëmbahen dhe Testohen.**

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

- ❑ ***Trendi i Rezultateve të Testimit të Mirëmbajtjes Preventive Elektrike***
  - Është një element kyç i **Programeve të Mirëmbajtjes Elektrike të Parametrave** si, p.sh: **Rezistenca e Izolimit, Rryma e Rrjedhjes, Kapaciteti, Faktor i Fuqisë, Temperatura e Kushinetave dhe Dridhjet dhe Temperatura e Mbështjelljes.**
  - **Trendi në rënie në këto Parametra tregon Probleme**
  - **Programi i Gjurimit të Zërit**, shpesh mund të njoftoj Personelin e Mirëmbajtjes në kohë rreth degradimit, që ndihon për të parandaluar Prishjen, ose të paktën për të minimizuar ndikimin e dështimit në Siguri dhe Produktivitet.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

- **Programi i Trendit të Rezultateve** duhet të **Strukturohet** duke marrë parasysh **Efektet e Faktorëve të jashtëm**, që ndikojnë në **Rezultatet e Matjes ose për të Korigjuar Rezultatet**, p.sh, **Leximet e Rezistencës së Izolimit**, të marra në Temperatura të ndryshueshme Korigjohen në një Temperaturë bazë të zakonshme.
- **Faktorët e jashtëm**, që ndikojnë në Rezultatet e Testimeve Elektrike janë: **Temperatura, Lagështia dhe Ngarkesa.**

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

### □ *Qasja e Analizës Sistematike të Prishjeve*

Hapat që duhen ndërmarrë pas një Prishje janë:

1. **Analiza e Shkakut të Prishjes**, p.sh, Releu nuk funksionon për shkak të Kontakteve të korroduara.
2. **Krahasimi i Shkaqeve të Prishjes**, për të përcaktuar nëse Problemi ka një Shkak Sistematik të Prishjes, p.sh, Mjedisi kimikisht aktiv në shembullin e mësipërm
3. **Nëse nuk ka Shkak Sistematik të Prishjes, Korrigjohet Prishja**, rifillon **Prodhimi** dhe vazhdon **Monitorimi**.
4. **Nëse problemi është i përhapur**, Kontaktohet Prodhuesi i Paisjeve, për **Masa Korrigjuese efektive** dhe nëse nuk kanë, vazhdohet me hapin tjetër.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

5. Nëse Problemi është specifik, p.sh problemi lidhet me Projektimin e Sistemit, Paisjet ose Mjedisin, përcaktohen Mangësitë specifike (përmes Testeve specifike të Monitorimit të Performancës, Monitorimit Mjedisor, etj.) dhe bëhet një Korrigjim i përshtatshëm.
6. Nëse Problemi lidhet me Keqtrajtim, Identifikoet dhe Korrigjohet.
7. Përcaktohet nëse Shkaku i Prishjes është shkaktuar nga një Mangësi në Program ose në Shkrimin Procedural, bëhen Korrigjimet e duhura.
8. Kryhet Testimi dhe Monitorimi i nevojshëm pas zgjidhjes së Problemeve.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

### ❑ *Testimi pas Mirëmbajtjes*

- **Testimi pas Mirëmbajtjes** ofron **Sigurinë**, se Mirëmbajtja është kryer me sukses dhe se Sistemi ose Komponentët janë rikthyer në gjendje funksionale.
- **Testimi pas Mirëmbajtjes** është shumë i rëndësishëm në **Funksionalitet** më të mirë të Kompanisë.
- **Testimi pas Mirëmbajtjes** kryhet duke ndjekur çdo **Procedurë**, që mund të ndikoj potencialisht në Funksionimin e një Komponenti, Nën sistemi ose Sistemi.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

### □ *Mbështetja Inxhinierike*

- **Mbështetja Inxhinierike** synon të siguroj që **Programi i Mirëmbajtjes Preventive** të adresoj siç duhet **Aspektet Inxhinierike** dhe **Logjistike të Mirëmbajtjes**.

**Mbështetja Inxhinierike** përfshin Funkcionet:

- Inxhinieria e Mirëmbajtjes
- Inxhinieria e Sistemeve
- Inxhinieria e Projektimit
- Trajnimet
- Menaxhimi i Pjesëve të Zëvendësimit dhe Materialeve
- Sigurimi i Cilësisë
- Kontrolli i Cilësisë.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

- **Inxhinieria e Mirëmbajtjes** është **Aktiviteti i Mbështetjes Inxhinierike**, që përfshihet drejtpërdrejt në **EPM**.
- Qëllimi i **Inxhinierisë të Mirëmbajtjes** është të **Optimizoj Programet e Mirëmbajtjes**, **përmes Planifikimit**, **Vlerësimit të vazhdueshëm** dhe **Përditësimit periodik të Politikave** dhe **Procedurave**.

### **Funksionet e Inxhinierisë së Mirëmbajtjes janë:**

- Zhvillimi dhe Kontrolli i Procedurave të Mirëmbajtjes
- Vlerësimi dhe Përditësimi Periodik i Praktikave dhe Procedurave
- Regjistrimi i të dhënave të Mirëmbajtjes.
- Zhvillimi i Programit të Inspektimit dhe Testimit
- Ofrimi i Udhëzimeve për Trajnimin e Personelit të Mirëmbajtjes

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

- Mbledhja dhe Trendi i të dhënave të Prishjeve dhe Besueshmërisë, Disponueshmërisë dhe Mirëmbajtjes së Pajisjeve
- Monitorimi dhe Trendi i Raporteve të Mirëmbajtjes Korrigjuese dhe Parandaluese
- Analiza e shkaqeve të Prishjes
- Monitorimi, Trendi dhe Analiza
- Identifikimi dhe Monitorimi i Parametrave të Performancës së Pajisjeve
- Identifikimi dhe Monitorimi i Treguesve të Performancës së Mirëmbajtjes.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve - EPM

- **Rezistenca ndaj ndryshimit, ndaj Krijimit dhe Zbatimit të Politikave, është shkaku kryesor i Dështimit të EPM.**
- **Nëse Menaxhmenti i lartë kapërcen këto, Rezultati sjell përmirësime në Besueshmëri, Disponueshmëri dhe Efikasitet.**
- **Këto ndryshime nuk janë të lehta dhe kërkojnë kohë dhe angazhim për t'u zbatuar.**
- **Menaxhimi Efektiv është çelësi i një Kompanie Efektive të Mirëmbajtjes.**

**Pjesa kryesore e një Programi Mirëmbajtjeje EPM përbëhet nga:**

- **Menaxhimi i Mirëmbajtjes,**
- **Kërkesat Teknike, dhe**
- **Aktivitetet që lidhen me Programin EPM.**

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve – EPM

### ☐ Menaxhimi i Mirëmbajtjes

- **Projektimi i Programit të Mirëmbajtjes** duhet të jetë plotësisht në përputhje me **Objektivat e Menaxhimit të Kompanisë** dhe se **Kosot e Mirëmbajtjes** i shtohet **Kostos Totale të Produktit** përfundimtar.
- Në përgjithësi, **Menaxhmenti ngurron të Investoj në një Program të Mirëmbajtjes**, edhe pse është i vetëdijshëm për të.
- Duke pasur parasysh këtë, **i mbetet Personelit të Kompanisë t'i tregoj Menaxhmentit se si një Program i Mirëmbajtjes i mirë, është Efektiv dhe i Justifikueshem nga ana e Kostos.**

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve – EPM

### ☐ Menaxhimi i Mirëmbajtjes

- **Planifikimi i Mirëmbajtjes së Paisjeve** duhet të përfshij **Përfitimet e Mirëmbajtjes së Planifikuar** dhe një **Rishikim të Kostove për shkak të Prishjeve**.
- **Programi i Mirëmbajtjes** duhet të jetë **Optimal**, duke marrë parasysh **Minimizimin e Kostove** dhe **Gjendjen e Paisjeve**.
- **Plani i Programit EPM** duhet të përfshijë gjithashtu **Artikuj që lidhen me Pajisjet e Testimit, Mjetet e kërkuara, Personelin e trajnuar dhe Kohën e nevojshme për të kryer Inspektime, Testime dhe Mirëmbajtje**.
- **Plani i Programit EPM** duhet të përmbaj edhe **Seksionin që lidhet me Sistemet e Monitorimit të Mirëmbajtjes**.

# Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve – EPM

## □ Menaxhimi i Mirëmbajtjes

Për të vendosur Mirëmbajtje Preventive dhe Testim Elektrik duhet të ndërmerren Hapat e mëposhtëm:

- **Përcaktimi i Faktorëve** që do të formojnë **Bazën e Programit të Mirëmbajtjes** (p.sh. Politika e ndarjes së Buxhetit për Planifikimi të Mirëmbajtjes)
- **Krijimi i një Analizë të Kostos**, që tregon **Përfitimet e Mirëmbajtjes së Planifikuar**.
- Përparësitë e Mirëmbajtjes së Pajisjeve Elektrike.
- **Përcaktimi i Teknikave** më të mira të Mirëmbajtjes, duke përzgjedhur **Metoda** dhe **Personel** më të mirë të Mirëmbajtjes.
- **Orari dhe Zbatimi i Programit**, me qëllim të përmirësimit të tij.
- Pasi të krijohet Programi, ai duhet të përbëhet nga element të tillë si: **Përgjegjësia, Inspektimi, Planifikimi**, etj.

# Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve – EPM

## ☐ Menaxhimi i Mirëmbajtjes

### ❖ *Përgjegjësia*

- **Përgjegjësia e Departamentit të Mirëmbajtjes** duhet të përcaktohet qartë nga **Skema Organizative**, me **Detyra** të qarta për secilën Nën-njësi të Mirëmbajtjes, të përcaktuara nga Menaxhmenti.
- Të gjitha Departamentet e Kompanisë duhet të informohen për **Detyrat e Departamentit të Mirëmbajtjes**.
- **Efektiviteti i Departamentit të Mirëmbajtjes** varet kryesisht nga sa mirë është i **organizuar Departamenti** dhe sa mirë janë të **Sinkronizuar anëtarët** e tij me njëri-tjetrin.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve – EPM

### ☐ Menaxhimi i Mirëmbajtjes

#### ❖ *Inspektimi*

- **Inspektimi** është thelbësor për **Suksesin e çdo Programi të Mirëmbajtjes**, sepse duhet të ndahet kohë e mjaftueshme për Inspektim, në mënyrë që të përcaktohen Kushtet për Paisjet e reja.
- **Qëllimi i Inspektimit** është të paralajmëroj për **Parregullsitë e Pajisjeve**.
- Kur **Inspektimi është i rregullt**, është e mundur të veprohet më shpejt në rast të Parregullsive të Paisjeve dhe kështu të **zvogëlohen Kostot**.

# Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve – EPM

## □ Menaxhimi i Mirëmbajtjes

### ❖ *Planifikimi i Mirëmbajtjes*

- Realizohet duke hartuar një **Orar** të qartë dhe të rrept të **Detyrave për Anëtarët individual**.
- **Orari i Mirëmbajtjes** duhet të bazohet në **Kohën minimale** për **Segmentet individuale të Mirëmbajtjes**.
- **Orari për Inspektimin, Mirëmbajtjen Rutinore dhe Detyrat e tjera, mund të ndryshoj** ndjeshëm për lloje të ndryshme të Paisjeve dhe varet nga shumë Faktorë, si: Moshë e Pajisjeve, Frekuenca e Riparimeve, Koha në shërbim, Kushtet mjedisore, Dëmet e shkaktuara nga trajtimi i dobët dhe Kushtet e Sigurisë.
- **Bazuar në këta Faktorë, zhvillohet një Orar** që siguron një **ekuilibër optimal** midis **Kostove të Mirëmbajtjes** dhe **Kostos së Zëvendësimit të Pajisjeve**.

# ☐ Menaxhimi i Mirëmbajtjes

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve – EPM

### ❖ Urdhëresat e Punës

- **Urdhëresat e Punës** ekzistojnë për të gjitha Departamentet e Inspektimit të Paisjeve dhe për Departamentet e Punës.
- **Urdhëresat e Punës shërbejnë për të ditur saktësisht se kur duhet të veprohet dhe në cilën pjesë të Paisjeve duhet të veprohet.**

Divizioni: \_\_\_\_\_  
 Departamenti: \_\_\_\_\_  
 Njësia: \_\_\_\_\_  
 Distrikti/ Nëndistrikti: \_\_\_\_\_  
 Data/ Ora: \_\_\_\_\_

Nr. Serik

1. Përshkrimi i punës që duhet të kryhet:

---



---



---



---

2. Zotohem se do të respektoj dhe zbatoj të gjitha rregullat e sigurisë në punë, si dhe përdorimin e PPM, veglat dhe mjetet e punës, gjatë zbatimit të detyrave që dalin nga kjo urdhëresë e punës. Zbatimi i rregullave do të bëhet në përputhje me rregulloret e kompanisë dhe Ligjin për siguri në punë (LIGJI NR. 04/L-161).

Nr. i punës	Emri dhe mbiemri	Nënshkrimi	Nr. i punës	Emri dhe mbiemri	Nënshkrimi
1	_____	_____	6	_____	_____
2	_____	_____	7	_____	_____
3	_____	_____	8	_____	_____
4	_____	_____	9	_____	_____
5	_____	_____	10	_____	_____

3. Materiali i nevojshëm për punë:

Nr.	Nr. i kërkesës	Emërtimi i materialit	Sasia
1			
2			
3			
4			
5			
6			
7			
8			

Vërejtje:

Të aplikohen masat mbrojtëse në punë në të gjitha stabilimentet dhe rrjetin elektrik, për të gjitha nivelet e tensionit 35 kV, 10 (20) kV dhe 0.4 kV.

Udhëheqësi

Koordinatori/ Menaxheri

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Kopja për Udhëheqësin/ Koordinatorin dhe punëtorët

# Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve – EPM

## ☐ Menaxhimi i Mirëmbajtjes

### ❖ *Monitorimi dhe Regjistrimi i të Dhënave*

- Për një Program të Mirëmbajtjes, duhet të ketë një **Proces të vazhdueshëm të Monitorimit dhe Regjistrimit të të Dhënave**, që lidhen me Funksonimin e Pajisjeve dhe Mirëmbajtjen e tyre.
- **Të Dhënat** duhet të jenë të disponueshme në çdo kohë, në mënyrë që çdo Problem të zgjidhet më lehtë dhe kështu Kostot e Mirëmbajtjes të minimizohen.
- **Të Dhënat** mund të përdoren për të **Monitoruar Besueshmërinë dhe Cilësinë e Pajisjeve** gjatë muajve ose viteve.
- Monitorimi dhe Regjistrimi i të Dhënave duhet bëhet vazhdimisht dhe me përgjegjësi.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve – EPM

### ☐ Kërkesat Teknike

**Kërkesat Teknike** mund të përmbliidhen si:

- ❖ **Testimi i Paisjeve**
- ❖ **Hierarkia e Paisjeve sipas rëndësisë**
- ❖ **Plani i zbatimit të EPM**
- ❖ **Zhvillimi i Procedurave për Programin EPM**

# Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve – EPM

## □ Kërkesat Teknike

### ❖ *Testimi i Paisjeve*

- Për një **Program Efektiv EPM** kusht është **Saktësia e të Dhënave** në Paisjet, e kjo zakonisht përfshin **Diagrame, Studime të sjelljes së Pajisjeve në kushte të L.sh, Diagrame Instalimesh elektrike dhe të Dhëna të tjera**, që mund të përdoren si **pika referimi** për proceset e ardhshme të **Testimit dhe Mirëmbajtjes**.

Diagramet dhe Vizatimet që përdoren zakonisht janë:

- **Diagram i Procesit:** Ndërlidh Nën-sistemet Individuale.
- **Blok-Diagramet:** Grup Blloqesh të ndërlidhura, të Nën-sistemeve.
- **Skemat Njëpolëshe (*Single Line Diagram*):** Një Diagram në të cilën rrjedha e energjisë ose qarqeve elektrike tregohet me një vijë të vetme dhe se në këtë lloj Diagrami, parimet fizike injorohen.



# Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve – EPM

## □ Kërkesat Teknike


- **Diagramet Skematike (të Komponenteve):** Tregojnë të gjitha Qarqet elektrike dhe Komponentet Individual në Qark.
- **Diagrami i Sekuencës (Pjesës) së Kontrollit:** tregon Pozicionet e kontakteve dhe kryqëzimeve.
- **Diagrami i Kontaktit:** Lokalizon dhe Identifikon Paisjet elektrike, terminalet, kabllot.
- **Diagrami i Ndërlidhjes:** Tregon vetëm lidhjet e jashtme të Kablllove.
- **Diagrami i Qarkut:** Tregon rregullimin fizik të Paisjeve në një Qark elektrik.
- **Studimi mbi Koordinimin e Pajisjeve gjatë L.Sh:** të Dhënat, që lidhen me Reletë dhe Pajisjet Mbrojtëse.

# Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve – EPM


## □ Kërkesat Teknike

Diagrami i Kontrollit elektrik:


- (a) Diagrami i Elementeve,
- (b) Diagrami i Lidhjeve, dhe
- (c) Diagrami i Ndërlidhjes



(a)




(b)



(c)

# Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve – EPM

## □ Kërkesat Teknike



Diagrami i instalimit të Qarkut të SEE

# Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve – EPM

## □ Kërkesat Teknike

- **Diagramet e Sistemit:** Këto Diagrame përdoren më shpesh për Sisteme të mëdha dhe përbëhen nga:
  - Sistemi i Kontrollit dhe Monitorimit
  - Sistemi i Ndriçimit
  - Sistemi i Ventilimit
  - Sistemi i Ngrohjes dhe Ftohjes
  - Sistemet e Emergjencës
  - Sisteme të tjera
- Diagramet e Sistemit mund të kenë pika kontakti, siç janë: Diagramet e Pajisjeve Elektrike, Diagramet e Sigurisë, Diagramet e Emergjencës, Sistemet Hidraulike, Pneumatike dhe Mekanike.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve – EPM

### □ Kërkesat Teknike

#### ❖ *Hierarkia e Pajisjeve sipas Rëndësisë*

- Është e vështirë të bëhet një përmbledhje cilësore e **Pajisjeve sipas Rëndësisë**, për shkak të ndryshimit në Rëndësinë e Pjesëve Individuale të Paisjeve, prandaj, krijohen **Ekipe njerëzish që janë përgjegjës për Renditjen e Paisjeve sipas Rëndësisë**.
- Të gjithë **Komponentet më të rëndësishme** duhet të shënohen në **Diagrame**.

# Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve – EPM

## □ Kërkesat Teknike

### ❖ *Plani i Zbatimit të EPM*

Disa Faktorë janë të rëndësishëm kur bëhet fjalë për Frekuencën e Mirëmbajtjes së pajisjeve:

- **Kushtet Mjedisore,**
- **Kushtet e Ngarkesës,**
- **Kërkesat e Rrjetit,**
- **Gjendja e Pajisjeve.**
- **Qëllimi i një Plani Zbatimi të EPM është të përcaktoj Gjendjen e Paisjeve dhe Sasinë e Punës së kërkuar, për Mirëmbajtje.**
- Si rregull, **Prodhuesit e Pajisjeve** Specifikojnë se sa shpesh kërkohet **Mirëmbajtja dhe Inspektimi i Paisjeve** dhe se këto **Intervale** merren duke marrë parasysh **Kushtet Standarde të Funkcionimit dhe Kushtet Mjedisore.**

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve – EPM

### □ Kërkesat Teknike

- **Frekuenca e caktuar e Mirëmbajtjes së Paisjeve**, nuk duhet të ndryshohet shpesh.
- Nëse ndodhin **Prishje të paparashikuara**, **Frekuenca e Mirëmbajtjes mund të rritet me 50 %**.
- Nëse **Mirëmbajtja nuk kërkohet për një Pajisje për një kohë të gjatë**, është e mundur të zvogëlohet **Frekuenca me 50 %**.
- Në përgjithësi, **Frekuenca e Mirëmbajtjes varion nga 6 muaj në 3 vjet**.

# Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve – EPM

## □ Kërkesat Teknike

### ❖ *Zhvillimi i Udhëzimeve dhe Procedurave të Programit EPM*

- Procedura dhe Udhëzime të zhvilluara për Servisimin e Pajisjeve dhe Komponentëve.
- Procedura për Mbylljen, Mbrojtjen, Mbivendosjen, Alarmet dhe Metodatat për Regjistrimin e të Dhënave dhe Raportimin e Kushteve të pazakonta tek autoriteti përkatës.
- Të dhënat e Regjistruara të Mirëmbajtjes duhet të përdoren për të **vlerësuar Rezultatet**, si një Tregues i Modifikimeve të mundshme në Programin e Mirëmbajtjes, pra Informacioni i regjistruar duhet të përdoret si të Dhëna historike dhe si reagim për Programin e Mirëmbajtjes.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve – EPM

### ☐ Aktivitetet e Programit EPM

**Aktivitetet e një Programi EPM janë:**

- ❖ **Mirëmbajtje Preventive dhe Testimi**
- ❖ **Riparimet e Sistemit**
- ❖ **Analiza e Prishjeve**
- ❖ **Strukturimi i të Dhënave të Mirëmbajtjes dhe Testimit.**

# Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve – EPM

## □ Aktivitetet e Programit EPM

### ❖ *Mirëmbajtja Preventive dhe Testimi*

- Ky Aktivitet përfshin **Inspektimin, Pastrimin, Rregullimin dhe Testimin e Pajisjeve**, për të siguruar Funksonimin pa probleme deri në Mirëmbajtjen e Planifikuar të radhës.
- **Mirëmbajtja Preventive dhe Testimi** gjithashtu lejojnë parashikimin e Prishjes së afërt të një Komponenti, në mënyrë që Zëvendësimi i tij të mund të Planifikohet pa pasoja katastrofike.
- Informacioni i Testimit mund të merret nga disa Standarde të ndryshme, siç janë: Shoqata e Inxhinierisë për Kabllo te Izoluara (ICEA), Shoqata Kombëtare e Mbrojtjes nga Zjarri (NFPA), Instituti i Inxhinierëve Elektrik dhe Elektronik (IEEE), Instituti Kombëtar Amerikan i Standardeve (ANSI), Shoqata Kombëtare e Prodhuesve të Pajisjeve Elektrike (NEMA), etj.

# Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve – EPM

## □ Aktivitetet e Programit EPM

### ❖ *Riparimet e Sistemit*

- Riparimi i Pajisjeve Elektrike dhe Makinerive përkatëse është një kërkesë themelore e një Programi Mirëmbajtjes së mirë.
- Mirëmbajtja duhet të kryhet Ekonomikisht dhe me Efikasitet.
- Qëllimi kryesor i Mirëmbajtjes duhet të jetë Shmangia e Prishjeve të papritura të Pajisjeve.
- Kur ndodh një Prishje, Pjesët Rezervë duhet të jenë në dispozicion për të bërë Riparimet e nevojshme.
- Personeli i Mirëmbajtjes duhet të jetë i trajnuar në mënyrë të përshtatshme për të kryer Riparimet menjëherë dhe siç duhet, për të minimizuar Kohën e Ndërprerjes.

## Mirëmbajtja Preventive e Paisjeve – EPM

### □ Aktivitetet e Programit EPM

#### ❖ ***Analiza e Prishjeve***

- Bëhen për të identifikuar Shkakun e Prishjeve.
- Shkaku i çdo Prishje duhet të analizohet në mënyrë që të merren Masa Korigjuese, për të shmangur ndërprerje të ngjashme.

#### ❖ ***Strukturim i të Dhënave të Mirëmbajtjes dhe Testimit***

- Njofton Personelin e Mirëmbajtjes për Përkeqësimin e Paisjeve.
- I lejon Personelit të Mirëmbajtjes të Monitoroj më mirë Paisjet e tilla ose lejon që të ndërmerren Veprime Korigjuese, për të parandaluar Prishjet Katastrofike.

## Planifikimi i EPM për Transformatorët

- **Transformatori** mund të shndërroj Tensionin nga niveli i ulët në të lartë, ose nga niveli i lartë në të ulët.
